

KOLEGJI "BIZNESI"

Nr. 488/20 Data: 16.12.20  
PRIZREN



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Prishtinë



## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

### Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi:

1. Kolegji BIZNESI-Prishtinë, rruga "Motrat Qiriazi" -29 të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi-Dekan, dhe
2. TIPTOP - GUNS L.L.C., Adresa: Faredin Hoti nr. 101/5 Prizren R. e Kosovës, me NRB 810975021 e përfaqësuar nga Ramiz Llugaxhiu-Drejtor.

### Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI- Prishtinë dhe TIPTOP - GUNS L.L.C. -Prizren, pajtohen për bashkpunim.

### Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. TIPTOP - GUNS L.L.C.-Prizren do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin BIZNESI, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, dhe dhënjën e sygjërimeve për nevojat e ekonomisë së tregut si palë e interesit nga jashtë, të bazuar në politikat e këtij institucioni.
2. Kolegji BIZNESI do të mbështesë në vazhdimësi TIPTOP - GUNS L.L.C.-Prizren ne aspektin e trajnimeve në fushat: **Menaxhimi i emergjencave** (mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparaturat për shuarjen e zjarrit), **Ekonomisë** (hartimin e pasqyrave financiare dhe planit të biznesit, në konsultim me personin përgjegjës për financat në kompani dhe me menaxhmentin e kompanisë), **Juridike** (hartimi i kontratave dhe rregulloreve, në

konsultim me menaxhmentin) dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit.

3. Kolegji BIZNESI do të mbështes, TIPTOP - GUNS L.L.C. -Prizren me stafin e saj akademik, për ligjërata nga lëmia e: Emergjencave, Ekonomisë dhe Jurispodencës-sipas nevojave eventuale që paraqet TIPTOP - GUNS L.L.C.

#### Neni 4

Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
2. Afati i këtij memorandumit është në kohë të pacaktuar dhe mund të ndërpritet nga secila palë nënshkruese e këtij memorandumit në çdo kohë pas njoftimit me shkrim. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët, në formë ANNEX-i.

#### Neni 5

Kopjet e Memorandumit

Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.

#### Neni 6

Hyrja në fuqi


Ky Memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

### PALËT NËN SHKRUESE

Kolegji BIZNESI Prishtinë

  
/Prof. Dr. Shyqer Kabashi/  
D e k a n

TIPTOP - GUNS L.L.C.

  
/Ramiz Llugaxhiu/  
Drejtore

Nënshkruar në Prishtinë, me datë 16 / 12 /2020